

PKR.nr.563/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit D. M. për shkak të veprës penale Mbatja në pronësi, kontrollë posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.26/2015 të dt: 01.10.2015, pas mbajtes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt:**12.12.2017** në prezencën e të akuzuarit Dardan Mamaj, dhe prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

**A K T G J Y K I M**

**I AKUZUARI:**

**D. M.**, nga i ati Sh., e ëma F. , mbiemri i vajzërisë E., i lindur më *data e lindjes...*, në f.sh. “S.”, KK-S., ku dhe tani jeton me nr. personal: *numri personal...*, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, ka të kryer zanatin instalues i ujit në Gjermani, jo i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** e ka mbajtur armën pa autorizim, ashtu që me dt; 19.12.2014 rreth orës 19:30 min, në aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ‘Adem Jashari’, gjatë kontrollit me X-rai e personave të autorizuar në valigjet e tani të pandehurit Dardan i cili ishte duke udhëtuar në relacionin Prishtinë - Myneh të Gjermanisë i është gjetur në posedim një elektroskok “Model Flashlight” dhe një mbushës elektrik, të përcaktuar sipas nenit 5 pikës 1.9 të ligjit 03/L-246 si armë, e të cilat me pas janë sekuestruar nga policia-,

-me çka ka kryer veprën penale Mbatja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 3,4,41,42,43,46,73 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Të akuzuarit **D. M.**

Për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së , i shqiptoi **DENIM ME GJOBË**, në shumën prej **300 € (treqind) euro**, të cilën shumë i njejtë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPPK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zavendësoi me denim burgu konform nenit 46 par. 3 të KPPK-se, ashtu qe gjdo 20 € ( euro) , të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

#### **DENIMI PLOTËSUES**

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit D. M. konfiskohet një (1) elektrohok "Flashlight" me mbajtës, si mjet me të cilin është kryer vepra penale, i cili është sekuestruar nga policia e Kosovës, dhe i njejtë duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari **D. M.**, obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumë prej **30 € (tridhjet) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

#### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.26/2015 të dt: 01.10.2015, kundër të akuzuarit D. M. për shkak të veprës penale Mbatja në pronësi, kontrollë posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë me dt: 12.12.2017, i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sçarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos te pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasyshë se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të njejtën ditë vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marr parasyshë se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasyshë pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, ka të kryer shkollën e mesme, jo i punësuar, i gjendjes se mesme ekonomike, më parë jo i gjykuar. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtorë dhe e gjyko si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke I aplikuar dispozitat ligjore për zbutjen e denimit , me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtën do të arrihet qëllimi I denimit .

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues është marrur konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.563/15, të dt. 12.12.2017**

**Procesmbajtësi,  
Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,  
Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Prokurori i shtetit dhe i akuzuari hoqën dorë nga drejta në ankesë .